



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Pimljeno/Prodato Received/Delivered	20.04.2021	1 viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHICK	1904/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.220/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca- kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari - anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.796/2019, të datës 15.03.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.21/2019 të datës 17.01.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. "Qamil Hoxha", Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.04.2021, mori këtë;

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.21/2019, e datës 17.01.2019, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 949/2018, i datës 26.12.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, me datë 10.11.2018 ka shpallur konkurs për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Parandalimin dhe Rintegrimin e Personave të Radikalizuar, tre (3) vende pune. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi mirëpo i njëjti nuk është përfshi në listën e ngushtë nga Komisioni Përzgjedhës.

Ankuesi i pakënaqur me mos përfshirjen e tij në listën e ngushtë, me datë 18.12.2018, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministria e Punëve të Brendshme. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë

28.12.2018, përmes vendimit me numër protokolli 949/2018 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Kundër Vendimit me numër protokolli 949/2018 të datës 28.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ankuesi, me datë 17.01.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 258/2019 të regjistruar me numër A.nr.21/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se procedura e rekrutimit për pozitën Zyrtar i Lartë për Parandalimin dhe Rintegrimin e Personave të Radikalizuar është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil. Te njëjtën kohe, ankuesi ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 15.03.2021, ka nxjerr Aktgjykim me numër A.nr.796/2019, përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 17.01.2019 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 258/2019 të regjistruar me numër A.nr.21/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 18.02.2018, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin e datës 28.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesën për punësim të ankuesit, me shkresat e bashkangjitura; Diplomën e datës 05.09.2017; Dëshmitë mbi përvojën e punës; Njoftimin e datës 20.12.2018; Listën e ngushtë; Listën e ngushtë për testim me gojë; Përcaktimin e kriterëve për përfshirje në listën e ngushtë; Përcaktimin e kriterëve për testim me shkrim; Regjistrin e Aplikacioneve; Regjistrin e Aplikacioneve të listës së ngushtë; Listën me emra që kanë hyrë në testim me shkrim; Autorizimin e datës 01.11.2018 të Ministrisë së Administratës Publike; Raportin Final të Rekomandimit nga Komisionit Rekrutues; Konkursin e datës 10.11.2018; Testin me shkrim; Kërkesën për punësim të Sh.K.Th, me shkresat e bashkangjitura; Diplomën e datës 28.01.2014; Marrëveshjen për shërbime të veçanta; Kërkesën për punësim të M.S, me shkresat e bashkangjitura; Diplomën e datës 18.02.2014; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 526/2019 të datës 30.01.2019, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e pa bazuar sepse:**

Ankuesi pretendon se procedura e rekrutimit nuk është zhvilluar sipas legjislacionit në fuqi, sepse i njëjti nuk është përfshirë në listën e ngushtë edhe pse i ka plotësuar kushtet e konkursit.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, ka analizuar konkursin e shpallur me datë 10.11.2018 për pozitën Zyrtar i Lartë për Parandalimin dhe Rintegrimin e Personave të Radikalizuar, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se kriteret e konkursit për këtë pozitë të punës kanë qenë:

- *Diplome Universitare; Fakulteti i Sigurisë, Fakulteti Juridik ose Shkenca Shoqërore;*
- *Se paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.*

Përkitazi me këtë, Kolegji ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe duke u bazuar në diplomën Nr.5081 të lëshuar me datë 21.12.2017 nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka

konstatuar se ankuesi ka përfunduar Fakultetin Juridik me datë 05.09.2017, andaj si rrjedhojë i njëjti nuk e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës profesionale, tre (3) vjeçare, siç kërkohet në konkurs. Andaj, bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me rastin e përgatitjes së listës së ngushtë ka vepruar në pajtim me dispozitat e Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 28 ku përcaktohet se: 1. Anëtarët e KPSHC- së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim; 1.1. Arsimi dhe Kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës; 1.3 Shkathtësia dhe aftësitë' dhe 1.4 Elementet tjera të meritës. Rrjedhimisht Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, konstaton se procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 18 paragrafin 1 ku përcaktohet se: Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, po ashtu konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit dhe nxjerrjes së Vendimi 949/2018 të datës 26.12.2018 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 në paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative , brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.220/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHC-së

